

**Fjala e Kryetarit të Prezencës
me rastin e 65-vjetorit të ekzekutimeve lidhur me incidentin
e “Bombës në Ambasadën Sovjetike” të 26 shkurtit, 1951**

**Presidenca, Salla “Skanderbeg”, Tiranë
26 shkurt 2016, ora 11:00**

I nderuar z. President!
E nderuar zj. Kaminsky
I nderuar z. Tufa,
I nderuar Ambasador Hoffmann
Të nderuar dëshmitar dhe familjarë
Të nderuar të ftuar!

Zoti President, ju falënderoj për mikpritjen tuaj sot. Gjithashtu, falënderimet më të sinqerta për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, jo vetëm për aktivitetin sot, por edhe për punën e tyre të palodhur me hulumtime akademike rreth kësaj pjese të dhimbshme të historisë së Shqipërisë.

Jemi sot këtu që të kujtojmë ngjarjet e "Bombës në Ambasadën Sovjetike", që të jemi dëshmitarë të vuajtjeve personale dhe të ndikimit që ato ngjarje patën në shoqëri. Të dy këto aspekte janë thelbësore. Kurrë nuk duhet të harrojmë individët: ata që u arrestuan, ata që u ekzekutuan, edhe familjet e tyre që u degdisën në internim. Po ashtu, kurrë nuk duhet të harrojmë qëllimin kryesor dhe pasojat e atyre krimeve të tmerrshme, terrorizimit e popullit që synohej me ato akte, e sidomos të intelektualëve.

Kohët e fundit kemi parë përpjekje të shtuara në shoqërinë shqiptare për ta kujtuar dhe për t'u përballur vërtet me të shkuarën totalitare të Shqipërisë. Për këtë arsye, Prezenca e OSBE-së iu bashkua këtyre përpjekjeve dhe nisi një nismë në vitin 2015 - me mbështetjen e qeverisë gjermane - për të nxitur dialogun gjithëpërfshirës në rang kombëtar, se si të përballemi me këtë të kaluar. Po punojmë veçanërisht me rininë, duke ndarë me ta informacion për të kaluarën komuniste, përfshi këtu edhe rrëfimin e historive nga vetë personat e persekutuar.

Të rinjtë shpesh ende nuk njohin as elementët bazë të regjimit komunist. Prandaj, kemi mendimin se kurrikula arsimore duhet të rishikohet me kujdes - përmes një procesi përfshirës - në mënyrë që të rinjtë të mësojnë jo vetëm për fakte dhe ngjarje si ekzekutimet pas incidentit të "Bombës në Ambasadën Sovjetike", por edhe që të zhvillojnë vlerësimin kritik të ngjarjeve historike, si dhe të kuptojnë rolin e tyre në sistemet e mëdha të qeverisjes dhe shtypjes.

Përkujtimi i ditëve të rëndësishme të historisë është pjesë e një procesi më të madh, që është trajtimi i trashëgimisë së regjimit totalitar në Shqipëri. Përshëndesim nismat për shndërrimin e disa objekteve komuniste në objekte përkujtimore, si Shtëpia e Gjetheve në Tiranë dhe,

veçanërisht, burgu i Spaçit. Për më tepër, Prezenca e OSBE-së po jep këshillim dhe ekspertizë për nismat që nxisin hapjen e drejtë dhe transparente të dosjeve të ish-Sigurimit.

Përkujtimi, studimi, mësimi dhe të folurit për të kaluarën totalitare, janë menyrat që garantojnë të ardhmen demokratike të Shqipërisë. Historia i përket të gjithë shoqërisë, por është edhe thellësisht personale, duke na detyruar kështu të punojmë në të dyja këto nivele për të arritur plotësisht paqësimin me të kaluarën.

Faleminderit.